



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.58

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9526 datë 11.5.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar për projektin e spitalit të Kavajës”.....	1639
Vendim i KM nr.319, datë 31.5.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.562, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e funksioneve të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të këshillit administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”..	1647
Vendim i KM nr.325, datë 31.5.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për hapjen e kutive të votimit, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, korrik 2005.....	1648
Vendim i KM nr.327, datë 31.5.2006	Për transferimin në pronësi të komunës qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës, të sipërfaqes 4600 m ² dhe objektit “Fjetinë, zyrë, mensë”, që përfshihet brenda saj, komponentë të pronës nr.550 “Kompania e ndërlidhjes” Barç, Korçë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	1648
Vendim i KM nr.328, datë 31.5.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar.....	1649

Vendim i KM nr.329, datë 31.5.2006	Për përballimin e shpenzimeve të komisionit bankar për veprimet për shpërndarjen e vlerave, kreditorëve të shoqërive huamarrëse.....	1649
Vendim i KM nr.332, datë 31.5.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.437, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen projekt kombëtar të studimit rajonal të zhvillimit të hapësirës Tiranë-Durrës”, të ndryshuar.....	1650
Vendim i KM nr.336, datë 31.5.2006	Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror”.....	1652
Vendim i KM nr.339, datë 31.5.2006	Për disa ndryshime në rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave.....	1653

L I G J
Nr.9526, datë 11.5.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR PËR PROJEKTIN E SPITALIT TË KAVAJËS”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar për projektin e Spitalit të Kavajës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4889, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PROJEKTI I SPITALIT TË KAVAJËS

MARRËVESHJA E KREDISË
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM
NDËRKOMBËTAR

Marrëveshje, datë _____ ndërmjet Republikës së Shqipërisë (këtej e tutje e quajtur Huamarrësi) dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (këtej e tutje i quajtur Fondi),

meqenëse shtetet anëtare të OPEC-ut, duke qenë të ndërgjegjshme për nevojën për solidarizim ndërmjet të gjitha vendeve në zhvillim dhe për rëndësinë e bashkëpunimit financiar ndërmjet tyre dhe vendeve të tjera në zhvillim, kanë krijuar Fondin për të siguruar mbështetje financiare për vendet në zhvillim, përveç instrumenteve ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe nëpërmjet të cilave shtetet anëtare të OPEC-ut i japin ndihmë financiare vendeve të tjera në zhvillim;

meqenëse Huamarrësi ka kërkuar ndihmë financiare nga fondi për financimin e projektit të përshkruar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje;

meqenëse Huamarrësi, ndërmjet të tjerash, ka kërkuar nga Banka Islamike për Zhvillim (IsDB) të ndihmojë në financimin e projektit përmes dhënies së një kredie;

dhe meqenëse Bordi Drejtues i Fondit ka miratuar dhënien e kredisë për Huamarrësin në shumën dy milionë e katërqind e njëzet mijë dollarë amerikanë (USD 2 420 000) sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, si dhe ka vendosur që t’i besojë Bankës Islamike për Zhvillim (IsDB) detyrën e administrimit të kredisë së siguruar sipas termave të kësaj Marrëveshjeje,

për sa më sipër, palët janë marrë vesh si vijon:

Neni 1
Përkufizime

1.01 Termat që përdoren në këtë Marrëveshje, në qoftë se nuk kërkohet ndryshe nga konteksti,

do të kenë kuptimet e mëposhtme:

a) “Fondi” nënkupton fondin OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar të krijuar nga shtetet anëtare të organizatës së vendeve eksportuese të naftës sipas Marrëveshjes së nënshkruar në Paris, më 28 janar 1976, siç është ndryshuar.

b) “Menaxhim i Fondit” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Fondit ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij.

c) “Administrator i kredisë” nënkupton Bankën Islamike për Zhvillim (IsDB) ose çdo agjenci tjetër siç mund të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit.

d) “Kredi” nënkupton kredinë e dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje.

e) “Dollar” ose “\$” nënkupton monedhën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

f) “Projekt” nënkupton projektin për të cilin është dhënë kredia, siç përshkruhet në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç mund të ndryshohet më vonë në marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit.

g) “Mallra” nënkupton pajisjet, furnizimet dhe shërbimet e kërkuara për projektin. Kosto e mallrave do të përfshijë gjithashtu koston e importit të mallrave në territorin e Huamarrësit.

h) “Agjenci Zbatuese” nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë së Huamarrësit ose çdo agjenci tjetër, siç mund të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit.

i) “Data e mbylljes” nënkupton datën e specifikuar sipas seksionit 2.10 të kësaj Marrëveshjeje, në të cilën përfundon e drejta e Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat e kredisë.

j) “Datë efektive” nënkupton datën e specifikuar sipas seksionit 7.01 të kësaj Marrëveshjeje në të cilën kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi.

Neni 2

Kredia

2.01 Një kredi në shumën dy milionë e katërqind e njëzet mijë dollarë amerikanë (USD 2 420 000) i jepet Huamarrësit nga Fondi sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2.02 Huamarrësi do të paguajë interes prej dy e tre të katërtat për qind (2.275%) në vit mbi shumën principale të kredisë së tërhequr dhe të mbetur herë pas here.

2.03 Huamarrësi do të paguajë sipas rastit një tarifë shërbimi në koeficientin një për qind (1%) në vit mbi shumën principale të kredisë së tërhequr dhe të mbetur, për të përballuar shpenzimet e administrimit të kredisë.

2.04 Interesi dhe tarifa e shërbimit do të paguhet në dollarë çdo gjashtë muaj, me 15 qershor dhe 15 dhjetor të çdo viti, në një llogari të fondit të caktuar për këtë qëllim nga Menaxhimi i Fondit.

2.05 Pasi kjo Marrëveshje të deklarohet efektive sipas seksionit 7.01 dhe në qoftë se Huamarrësi dhe Fondi nuk do të bien dakord ndryshe, shumat e kredisë mund të tërhiqen sipas rastit për të përballuar shpenzimet e bëra pas datës 15 mars 2005 ose që do të bëhen në data të mëvonshme në lidhje me kostot e arsyetuara të mallrave të kërkuara për projektin që do të financohen nga kredia siç përshkruhet në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe në ndryshimet e shtojcës të miratuara nga Menaxhimi i Fondit.

2.06 Me përjashtim të rasteve kur Fondi bie dakord ndryshe, tërheqjet nga kredia mund të bëhen në monedha në të cilat shpenzimet e përmendura në seksionin 2.05 janë paguar ose po paguhet. Në rast se pagesa do të kërkohet në një monedhë të ndryshme nga dollari, kjo pagesë do të bëhet efektive në bazë të kostos reale të dollarit, të dhënë nga fondi për të përballuar kërkesën. Menaxhimi i Fondit do të veprojë si agjenti i Huamarrësit në blerjen e monedhave. Tërheqjet për shpenzime në monedhën e Huamarrësit, nëse ka, do të bëhen në dollarë sipas kursit të këmbimit në kohën e tërheqjes dhe, në mungesë të kursit të këmbimit, sipas një kursi të arsyeshëm, siç do të vendosë Menaxhimi i Fondit sipas rastit.

2.07 Të gjitha aplikimet për tërheqje do të përgatiten në përputhje me “Procedurat e disbursimit të Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar” të miratuara në maj 1983, një kopje e të cilave i është dhënë Huamarrësit. Një kopje origjinale e çdo kërkesë për tërheqje do t’i dorëzohet Fondit nga përfaqësuesi i Huamarrësit, i caktuar në ose në përputhje me seksionin 8.02. Çdo kërkesë e dorëzuar në këtë mënyrë do të shoqërohet me dokumente dhe evidenca të tjera në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Menaxhimin e Fondit, që Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga kredia

shumën të cilën ka kërkuar dhe që shuma që do të tërhiqet do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në këtë Marrëveshje.

2.08 Huamarrësi do të ripagujë principalin e kredisë në dollarë ose në një monedhë tjetër lehtësisht të konvertueshme, të pranueshme për Menaxhimin e Fondit, në një shumë të barasvlefshme me shumën e përcaktuar në dollarë, sipas kursit të këmbimit të tregut që dominon në kohën dhe vendin e ripagimit. Ripagimi do të bëhet në tridhjetë këste të barabarta gjashtëmujore, duke filluar nga data 15 dhjetor 2010, pas një periudhe kohe faljeje (grace) që vazhdon deri në këtë datë dhe më pas në përputhje me shtojcën e amortizimit në këtë Marrëveshje. Çdo kësht do të jetë në shumë tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë dollarë (\$80 660) me përjashtim të kështit të fundit dhe njëkohësisht të tridhjetë, kësht që do të jetë në shumën tetëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë dollarë (\$80 860). Të gjitha kështet e përmendura më sipër do të transferohen në datën e ripagimit në llogarinë e Fondit sipas kërkesës nga Menaxhimi i Fondit.

2.09 a) Huamarrësi merr përsipër të sigurojë se asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të ketë prioritet mbi këtë kredi në alokimin, realizimin ose shpërndarjen nga konvertimi i monedhës të mbajtur nën kontroll ose për përfitime të Huamarrësit. Për të arritur këtë, nëse do të vihet një garanci mbi asetet publike (siç përshkruhet në seksionin 2.09 c), si një siguri për ndonjë borxh të jashtëm, që do të rezultojë ose mund të rezultojë në një prioritet për përfitimin nga kreditori të borxhit të jashtëm në alokimin, realizimin ose shpërndarjen nga konvertimi i monedhës, garancia do të sigurojë *ipso facto*, kundrejt asnjë shpenzimi nga ana e Fondit, në mënyrë të barabartë principalin dhe tarifat mbi kredinë dhe Huamarrësi, në krijimin apo lejimin për të krijuar një garanci, do të vendosë një dispozitë për këtë qëllim; me kusht që, nëse për ndonjë arsye tjetër ligjore ose kushtetuese për të cilën garancia nuk mund të vihet në lidhje me asetet e ndonjë departamenti politik ose administrativ, Huamarrësi do të sigurojë menjëherë dhe pa asnjë shpenzim nga Fondi principalin dhe tarifat mbi kredinë me një garanci të barasvlefshme mbi asete të tjera publike të kënaqshme për Fondin.

b) Dispozita e mësipërme nuk do të ketë efekt për:

i) çdo garanci të vënë mbi pasurinë në kohën e blerjes së saj, vetëm si siguri për pagesën e çmimit të blerjes së asaj pasurie;

ii) çdo garanci të vënë sipas procedurave të zakonshme të transaksioneve bankare dhe që siguron një borxh që shlyhet jo më shumë se një vit pas datës së tij.

c) Siç përdoret në këtë seksion, termi “asete publike” nënkupton asete të Huamarrësit ose të ndonjë departamenti politik ose administrativ ose të ndonjë enti në pronësi, të kontrolluar nga, ose që vepron për llogari apo për përfitime të Huamarrësit apo të ndonjë departamenti të tij, duke përfshirë arin dhe asete të tjera të këmbimit të huaj që mbahen nga ndonjë institucion që kryen funksionet e bankës qendrore ose të fondit të stabilizimit të këmbimit, ose funksione të ngjashme, për Huamarrësin.

2.10 E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga kredia do të përfundojë më 31 dhjetor 2007 ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar nga Menaxhimi i Fondit. Menaxhimi i Fondit do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 3

Zbatimi i projektit; prokurimi

3.01 Huamarrësi do të zbatojë projektin me përpikmëri dhe efikasitet dhe në përputhje me praktika të sakta administrative financiare dhe inxhinierike dhe do të sigurojë, sapo të jetë e nevojshme, fondet, pajisjet, shërbimet dhe burime të tjera, përveç shumave të kredisë, të kërkuara për këtë qëllim.

3.02 Huamarrësi do të sigurojë se aktivitetet e departamenteve dhe agjencive të tij në lidhje me zbatimin e projektit janë kryer dhe koordinuar në përputhje me politika dhe procedura të sakta administrative.

3.03 a) Huamarrësi merr përsipër të sigurojë ose të marrë masat e duhura për sigurimin e mallrave të importuara që do të financohen nga kredia kundër rreziqeve që mund të ndodhin gjatë transportimit dhe livrimit në vendin e përdorimit ose instalimit dhe se çdo zhdëmtim për një siguracion

të tillë do të mund të paguhet në çdo monedhë që përdoret lirisht nga Huamarrësi, për të zëvendësuar apo riparuar këto mallra.

b) Në rast se nuk bihet dakord ndryshe nga Fondi, të gjitha mallrat dhe shërbimet të financuara nga shumat e kredisë do të përdoren vetëm për projektin.

c) Në rast se nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit “Udhëzimet e prokurimit për kredi të dhëna nga Fondi OPEC”, e miratuar më 2 nëntor 1982, një kopje e së cilës i është dhënë Huamarrësit, do të zbatohen për prokurimin e mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje.

3.04 a) Huamarrësi do t’i dorëzojë Menaxhimit të Fondit, menjëherë pas përgatitjes, planet, specifikimet, dokumentet e kontratës dhe të ndërtimit, planin e prokurimit për projektin dhe çdo modifikim material ose shtesa, në mënyrë të hollësishme siç do të kërkohej në mënyrë të arsyetuar nga Menaxhimi i Fondit.

b) Huamarrësi:

i) do të mirëmbajë regjistrime dhe procedurat e duhura për të regjistruar dhe monitoruar ecurinë e projektit (përfshirë koston dhe përfitimet që rrjedhin prej tij), do të identifikojë mallra dhe shërbime që do të financohen nga kredia dhe të bëjë të njohur përdorimin e tyre në projekt;

ii) do të bëjë të mundur që përfaqësuesit e Menaxhimit të Fondit të vizitojnë terrenet e ndërtimit të përfshira në projekt dhe të shqyrtojnë mallrat dhe punimet e financuara nga kredia si dhe çdo regjistrim dhe dokument përkatës;

iii) do t’i dorëzojë Menaxhimit të Fondit në intervale kohe të rregullta, të gjithë informacionin që Menaxhimi i Fondit do të kërkojë në mënyrë të arsyetuar në lidhje me projektin, koston dhe, sipas nevojës, përfitimet që rrjedhin prej tij, shpenzimet nga shumat e kredisë dhe mallrat, punimet dhe shërbimet të financuara nga këto shuma, si dhe një raport tremujor mbi ecurinë e zbatimit të projektit.

c) Menjëherë pas përfundimit të projektit, por në çdo rast jo më vonë se 6 muaj pas datës së mbylljes ose një datë të mëvonshme, për të cilën të bihet dakord midis Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t’i dorëzojë Menaxhimit të Fondit një raport, në qëllim dhe përmbajtje siç do të kërkohej nga Menaxhimi i Fondit, mbi zbatimin dhe shfrytëzimin fillestar të projektit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje, nga Huamarrësi dhe Fondi dhe përmbushjen e qëllimeve të kredisë.

3.05 Huamarrësi do të mbajë regjistrimet e duhura për të pasqyruar në përputhje me praktikën e sakta financiare, veprimet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me projektin, departamentet apo agjencitë e Huamarrësit, që janë përgjegjëse për zbatimin e projektit ose të një pjese të tij dhe do t’i vënë këto regjistrime në dispozicion të Menaxhimit të Fondit sipas kërkesës.

3.06 Për aq sa është në përputhje me këtë Marrëveshje, Huamarrësi do t’i bindet *vis-à-vis* të gjitha kushteve të Fondit në lidhje me zbatimin dhe administrimin e projektit, ndërsa ai pranon t’i referohet atij në Marrëveshjen e nënshkruar ose për t’u nënshkruar me IsDB-në për financimin e pjesshëm të këtij projekti, si dhe IsDB-së në këtë Marrëveshje për qëllime të dispozitës për referencën ndaj Fondit.

3.07 Subjekt i kushtit të seksionit 3.06, Huamarrësi do të konsultohet me Fondin përpara se të bjerë dakord me IsDB-në për amendimin e kushteve të Fondit në lidhje me zbatimin dhe administrimin e projektit. Asnjë amendim nuk do të jetë pjesë e Marrëveshjes pa marrë paraprakisht miratimin e Fondit.

3.08 Duke pranuar plotësisht rolin e administratorit të kredisë, për mbikëqyrjen e zbatimit të projektit, duke përfshirë rishikimin dhe miratimin e kontratave, miratimin e prokurimeve, si dhe miratimin e tërheqjes së kërkesave, Huamarrësi dhe administratori i kredisë do të bashkëpunojnë plotësisht me njëri-tjetrin për të siguruar përmbushjen e qëllimeve të kredisë. Në lidhje me sa më sipër, Huamarrësi herë pas here:

a) do të shkëmbejë pikëpamje me përfaqësuesit e administratorit të kredisë dhe Fondit, në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me ecurinë e projektit, përfitimet e arritura prej saj, si dhe realizimin e detyrimeve prej Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me kredinë;

b) do të njoftojë menjëherë përfaqësuesit e administratorit të kredisë dhe Fondit për situata që prekin ose kërcënojnë të prekin ecurinë e projektit, për përmbushjen e detyrimeve sipas Marrëveshjes ose përmbushjen e qëllimeve të kredisë.

3.09 Të gjitha referencat ndaj Huamarrësit në këtë nen do të përfshijnë, në mënyrë të dyanshme, referencat ndaj Agjencisë Zbatuese.

Neni 4 **Përfshirje**

4.01 Kjo Marrëveshje dhe çdo marrëveshje shtesë ndërmjet palëve të saj do të përfshihet nga taksat, tatimet apo detyrimet e vëna nga, ose më territorin e Huamarrësit, mbi ose në lidhje me zbatimin, livrimin apo regjistrimet sipas Marrëveshjes.

4.02 Principali, interesi dhe tarifat e shërbimit mbi kredinë do të paguhet pa zbritje për dhe të përfshihet nga tarifa apo kufizime të çdo lloji të vendosura nga ose në territorin e Huamarrësit.

4.03 Të gjitha dokumentet e Fondit, regjistrimet, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen si konfidenciale nga Huamarrësi, nëse nuk bihet dakord ndryshe nga Fondi.

4.04 Fondi dhe asetet e tij nuk do t'i nënshtrohen masave të shpronësimit, nacionalizimit, sekuestrimit, bllokimit apo përvetësimit në territorin e Huamarrësit.

Neni 5 **Përshpejtimi i afatit të kthimit; pezullimi dhe anulimi**

5.01 Nëse një nga ngjarjet e mëposhtme ndodh ose vazhdon për periudhën e specifikuar më poshtë, atëherë në çdo moment gjatë vazhdimit të ngjarjes, Menaxhimi i Fondit mund të deklarojë, duke njoftuar dhe Huamarrësin, pagesën e menjëhershme të principalit të mbetur të kredisë bashkë me interesat dhe tarifat e shërbimit mbi të; në këtë rast, principali i mbetur i kredisë, bashkë me interesat dhe tarifat e shërbimit, do të paguhet menjëherë:

a) Ndodh një dështim që vazhdon për një periudhë prej 30 ditësh në pagesën e një kësti të principalit ose të interesit, ose të tarifave të shërbimit sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër nëpërmjet së cilës Huamarrësi ka marrë një kredi nga Fondi;

b) Ndodh një dështim në përmbushjen e ndonjë detyrimi nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas Marrëveshjes së projektit, nëse ka, i cili vazhdon për një periudhë prej 60 ditësh pas njoftimit që Fondi i jep Huamarrësit.

5.02 Huamarrësi, duke njoftuar Fondin, mund të anulojë çdo shumë të kredisë të cilën Huamarrësi nuk e ka tërhequr para dhënies së njoftimit. Fondi, duke njoftuar Huamarrësin, mund të pezullojë ose t'i japë fund së drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje nga kredia nëse ndodh ndonjë nga ngjarjet e përmendura në seksionin 5.01 (a) dhe (b) ose nëse e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga kredia e IsDB-së të përmendur në parathënien e kësaj Marrëveshjeje është pezulluar ose anuluar, ose ndodh ndonjë ngjarje e jashtëzakonshme që do të pengojë zbatimin me sukses të projektit ose Huamarrësin për të shlyer detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë me fuqi dhe efekt të plotë, përveçse kur specifikohet në këtë nen pavarësisht nga përshpejtimi i afatit të kthimit të kredisë sipas seksionit 5.01 ose pezullimit apo anulimit të saj sipas seksionit 5.02.

5.04 Me përjashtim të rasteve kur bihet dakord ndryshe midis Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit, çdo anulim do të zbatohet *pro rata* në raport me kthimin e shumës principale të kredisë që do të paguhet pas datës së këtij anulimi.

Neni 6 **Zbatueshmëria, ndërprerja e fondit, arbitrazhi**

6.01 Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë Marrëveshje do të jenë të vlefshme dhe në fuqi në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht nga legjislacioni i brendshëm që bie në kundërshtim. Asnjë nga palët e Marrëveshjes nuk ka të drejtë, në asnjë rrethanë, të ngrejë pretendimin se ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme dhe e pafuqishme për ndonjë arsye.

6.02 Menaxhimi i Fondit do të njoftojë menjëherë Huamarrësin kur merret një vendim për shkrirjen e Fondit në përputhje me marrëveshjen e themelimit të Fondit. Në rast shkrirjeje, kjo Marrëveshje kredie mbetet në fuqi dhe Menaxhimi i Fondit do të njoftojë Huamarrësin për marrëveshjet zëvendësuese për ripagimin e kredisë, siç mund të jetë përcaktuar nga autoriteti përkatës

i Fondit për një rast të tillë.

6.03 Palët e kësaj Marrëveshjeje do të përpiqen të zgjidhin miqësisht të gjitha mosmarrëveshjet ose divergjencat ndërmjet tyre, që rrjedhin nga, ose në lidhje me këtë Marrëveshje. Nëse mosmarrëveshja apo divergjenca nuk mund të zgjidhet miqësisht, ajo do të adresohet për arbitrazh nga Gjykata e Arbitrazhit siç specifikohet më poshtë:

a) Procedurat për arbitrazh mund të ngrihen nga Huamarrësi ndaj Fondit ose e anasjellta. Në të gjitha rastet, procedurat për arbitrazh do të fillojnë me një njoftim nga pala që ankohet ndaj palës së paditur.

b) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjykatës të përzgjedhur si më poshtë: i pari nga pala ankuese, i dyti nga pala e paditur dhe i treti (që këtej e tutje i quajtur Kryegjykatësi) me marrëveshje ndërmjet dy gjykatësve. Nëse brenda 30 ditësh nga njoftimi i institucionit të arbitrazhit pala e paditur dështon të zgjedhë një gjykatës, ky gjykatës do të zgjidhet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e palës që ka filluar procedurat. Nëse dy gjykatësit dështojnë të bien dakord për gjykatësin brenda 60 ditësh pas datës së zgjedhjes së gjykatësit të dytë, Kryegjykatësi do të zgjidhet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

c) Gjykata e Arbitrazhit do të takohet në kohën dhe vendin e caktuar nga Kryegjykatësi. Më pas do të vendosë ku dhe kur do të zhvillohet. Gjykata e Arbitrazhit do të caktojë çështjet procedurale dhe çështjet që kanë të bëjnë me kompetencat e saj.

d) Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të merren me shumicë votash. Vendimi i Gjykatës, që mund të merret edhe nëse njëra prej palëve tërhiqet nga procesi, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët.

e) Njoftimi ose procesi në lidhje me procedurat e përmendura në këtë seksion ose në lidhje me procedurat për të sjellë në fuqi vendimin e marrë sipas këtij seksioni do të bëhet në mënyrën e përcaktuar në seksionin 8.01.

f) Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë për mënyrën sipas së cilës do të përballohen shpenzimet e arbitrazhit nga njëra apo të dyja palët në mosmarrëveshje.

Neni 7

Data e hyrjes në fuqi; përfundimi i marrëveshjes

7.01 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Fondi do t'i japë Huamarrësit njoftimin e pranimit të provës së kërkuar në seksionet 7.02 dhe 7.03.

7.02 Huamarrësi do t'i dërgojë Fondit prova të kënaqshme se:

a) Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit është autorizuar dhe ratifikuar sipas të drejtave kushtetuese të Huamarrësit;

b) Marrëveshja e kredisë në lidhje me kredinë e IsDB-së të përmendur në parathënien e kësaj Marrëveshjeje është deklaruar efektive ose do të deklarohet efektive njëkohësisht me këtë Marrëveshje.

7.03 Në vazhdim të seksionit 7.02, Huamarrësi do t'i dorëzojë Fondit një certifikatë të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, ose departamenti ligjor i qeverisë, që vërteton se kjo Marrëveshje është autorizuar dhe ratifikuar nga Huamarrësi dhe përbën në angazhim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin në përputhje me kushtet e saj.

7.04 Nëse kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi dhe nuk është bërë efektive deri më 14 mars 2006, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë, në rast se Fondi, pas marrjes në konsideratë të arsyeve të vonësës, nuk do të caktojë një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni.

7.05 Kur e gjithë shuma principale e kredisë do të jetë ripaguar dhe interesat dhe të gjitha tarifat që rrjedhin nga kredia do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë.

Neni 8

Njoftimi, përfaqësimi, modifikimi

8.01 Çdo njoftim ose kërkesë e bërë ose e lejuar të jepet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim. Një njoftim ose kërkesë e tillë do të konsiderohet e dhënë ose e bërë siç duhet kur i dërgohet dorazi, me postë ose me telefax palës së cilës i duhet dhënë ose bërë, në adresën e palës së specifikuar më poshtë ose në çdo adresë tjetër të dhënë me shkrim nga pala tjetër palës që jep njoftimin ose bën kërkesën.

8.02 Çdo masë e kërkuar ose e lejuar për t'u marrë dhe çdo dokument i kërkuar ose i lejuar për t'u ekzekutuar sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit do të merret ose ekzekutohet nga Ministri i Financave i Huamarrësit ose nga një zyrtar tjetër i autorizuar prej tij me shkrim.

8.03 Çdo përmirësim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të miratohet në emër të Huamarrësit me shkrim nga përfaqësuesi i Huamarrësit i caktuar nga, ose sipas seksionit 8.02, me kusht që sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, përmirësimi të jetë i arsyeshëm për rrethanat dhe nuk do t'i rrisë ndjeshëm detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes.

8.04 Çdo dokument i dërguar sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentet në një gjuhë tjetër do të shoqërohen me përkthim në anglisht të vërtetuar si përkthim i miratuar dhe ky përkthim do të jetë përfundimtar ndërmjet palëve.

Në prani të palëve, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruhet në Vjenë kjo Marrëveshje në dy kopje origjinale në gjuhën angleze me të njëjtën vlerë dhe pasoja në ditën dhe vitin e shënuar këtu.

Për Huamarrësin:
Emri:
Adresa: Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Telefax: (355) 4 228494

Për Fondin OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar:
Emri: Sh.T.Jamal Nasser Lootah
President i Bordit Drejtues
Adresa:Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
P.O.Box 995, A-1011, Vjenë, Austri
Telefax: (43) 1 5139238

SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti synon të sigurojë shërbime mjekësore me nivel të pranueshëm për popullsinë e qytetit të Kavajës dhe periferinë e tij nëpërmjet ndërtimit të një spitali të ri, si dhe të sigurimit të pajisjeve dhe të aparaturave moderne mjekësore për shërbimet e nevojshme mjekësore. Projekti përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

a) Punimet civile (ndërtimi) përfshijnë ndërtimin e dy godinave, të quajtura godina kryesore dhe ajo e njësisë mbështetëse, që do të zënë një sipërfaqe totale prej rreth 5600 m².

b) Pajisjet dhe aparaturat mjekësore konsistojnë në sigurimin e 181 artikujve, pajisje dhe aksesore mjekësore, duke përfshirë furnizimin me 2 ambulanca të kujdesit intensiv, si dhe me 2 ambulanca emergjence.

c) Shërbimet e konsulencës (projektimi dhe mbikëqyrja) përfshijnë punësimin e konsulentëve për projektimin e projektit, për mbikëqyrjen e punimeve civile ndërtimore, si dhe për prokurimin e pajisjeve mjekësore të spitalit.

d) Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU), përfshin një menaxher projekti, një koordinator projekti/llogaritar, si dhe një sekretare ekzekutive.

e) Shërbimet e auditimit, një seminar dhe një vizitë familjarizuese.

SHTOJCA II ALOKIMI I KREDISË

1. Nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit, të ardhurat e kredisë në shumën dy milionë e katërqind e njëzet mijë dollarë amerikanë (USD 2 420 000) do të përdoren për financimin e 100% të kostos së aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, si dhe për

financimin 10% të kostos së komponentëve të kontingjencës së projektit, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin (b) të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje.

2. Pavarësisht nga alokimi i një shume të kredisë ose përqindjes së disbursimit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, nëse Menaxhimi i Fondit ka vlerësuar në mënyrë të arsyetuar se shuma e kredisë së alokuar për njërin prej komponentëve do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord të të gjitha shpenzimeve për këtë komponent, menaxhimi i fondit duke njoftuar Huamarrësin, mund (i) të bëjë rialokim për këtë komponent, deri në masën e kërkuar për të përballuar mungesën e vlerësuar, shumat e kredisë të cilat janë alokuar për një komponent tjetër dhe që, sipas mendimit të menaxhimit të fondit, nuk nevojiten për shpenzime të mëtejshme; dhe (ii) nëse një rialokim i tillë nuk mund të përballojë mungesën e vlerësuar, të pakësojë përqindjen e disbursimit të këtyre shpenzimeve, me qëllim që tërheqjet e mëtejshme në lidhje me këtë komponent të mund të vazhdojnë deri sa të jenë bërë të gjitha shpenzimet nën të.

SHTOJCA III GRAFIKU I AMORTIZIMIT

Data e ripagimit	Shuma për t'u paguar (e shprehur në USD)
15 dhjetor 2010	80,660
15 qershor 2011	80,660
15 dhjetor 2011	80,660
15 qershor 2012	80,660
15 dhjetor 2012	80,660
15 qershor 2013	80,660
15 dhjetor 2013	80,660
15 qershor 2014	80,660
15 dhjetor 2014	80,660
15 qershor 2015	80,660
15 dhjetor 2015	80,660
15 qershor 2016	80,660
15 dhjetor 2016	80,660
15 qershor 2017	80,660
15 dhjetor 2017	80,660
15 qershor 2018	80,660
15 dhjetor 2018	80,660
15 qershor 2019	80,660
15 dhjetor 2019	80,660
15 qershor 2020	80,660
15 dhjetor 2020	80,660
15 qershor 2021	80,660
15 dhjetor 2021	80,660
15 qershor 2022	80,660
15 dhjetor 2022	80,660
15 qershor 2023	80,660
15 dhjetor 2023	80,660
15 qershor 2024	80,660
15 dhjetor 2024	80,660
15 qershor 2025	80 860
Totali:	2 420 000

VENDIM Nr.319, datë 31.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.562, DATË 12.8.2005 TË KËSHILLIT TË

**MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E FUNKSIONEVE TË PËRFAQËSUESVE TË
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË PËRBËRJE TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV TË
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 72 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të përcaktuar në pikën 1 të vendimit nr.562, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, emërtimet:

“Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale Ministria e Financave	ministër; Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Buxhetit”
---	--

Zëvendësohen me:

“Ministria e Financave Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	ministër; zëvendësministër”.
---	-------------------------------------

2. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**VENDIM
Nr.325, datë 31.5.2006**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR KOMISIONIN
QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR HAPJEN E KUTIVE TË VOTIMIT, TË PËRDORURA
NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KORRIK 2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 29 e 180 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 2 500 000 (dy milionë e pesë qind mijë) lekësh, për t’u përdorur për paga dhe për materiale të përgjithshme, për hapjen e kutive të votimit, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, korrik 2005.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.327, datë 31.5.2006

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KOMUNËS QENDËR BULGAREC, TË QARKUT TË KORÇËS, TË SIPËRFAQES 4600 M² DHE OBJEKTIT “FJETINË, ZYRË, MENSË”, QË PËRFSHIHET BRENDA SAJ, KOMPONENTË TË PRONËS NR.550 “KOMPANIA E NDËRLIDHJES” BARÇ, KORÇË, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 4600 m² dhe objekti “Fjetinë, zyrë, mensë”, që përfshihet brenda saj, komponentë të pronës nr.550 “Kompania e ndërlidhjes”, Barç, Korçë, me numër pasurie 368, në zonën kadastrale nr.1101, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, t’i kalojnë në pronësi komunës Qendër Bulgarec, për sistemimin e shkollës 9-vjeçare të fshatit Barç të qarkut të Korçës.

2. Kjo sipërfaqe dhe objekti “Fjetinë, zyrë, mensë” të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Komunës Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës, i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, të ndjekin procedurat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.328, datë 31.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 shkronja “c”, 20, shkronjat “e” e “g” dhe 29, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statuti i nëpunësit civil” dhe të neneve 78-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, paragrafi i fundit i pikës 2 të kreut I dhe paragrafi i fundit i pikës 1 të kreut II, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.329, datë 31.5.2006

PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË KOMISIONIT BANKAR PËR VEPRIMET PËR SHPËRNDARJEN E VLERAVE, KREDITORËVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 13 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Grupit Mbikëqyrës, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri “Shpenzime”, t’i shtohet fondi prej 3 755 200 (tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekësh, për pagesën e komisionit të shërbimit bankar, për veprimet që kryhen në sportelet e degëve të Bankës Kombëtare Tregtare, për shpërndarjen e vlerave financiare 37 552 kreditorëve, të cilët kanë depozituar kapitalet në shoqëritë huamarrëse.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Grupi Mbikëqyrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.332, datë 31.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.437, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPALLJEN PROJEKT KOMBËTAR TË STUDIMIT RAJONAL TË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRËS TIRANË-DURRËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 13 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.437, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Listat nr.1 e nr.2 zëvendësohen me listat me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pika 5 shfuqizohet.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Drejtoria e Politikave të Planifikimit Urban, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, bën bashkërendimin e punës, studimore e projektuese, të Institutit të Studimeve dhe Projektmeve të Urbanistikës dhe të institucioneve të tjera, të specializuara, të përmendura në listën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

4. Ngarkohet Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e

këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA NR.1

KOMISIONI SHTETËROR PËR PROJEKTIN KOMBËTAR

“Studimi rajonal i zhvillimit të hapësirës Tiranë-Durrës”

1. Zëvendëskryeministri	Kryetar
2. Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	Anëtar
3. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	Anëtar
4. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	Anëtar
5. Ministri i Financave	Anëtar
6. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Anëtar
7. Ministri i Brendshëm	Anëtar
8. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar
9. Sekretari Shkencor i Akademisë së Shkencave	Anëtar
10. Drejtori i Institutit të Statistikave	Anëtar
11. Kryetari i Këshillit të Qarkut, Tiranë	Anëtar
12. Kryetari i Këshillit të Qarkut, Durrës	Anëtar
13. Drejtor i Politikave të Planifikimit Urban në Ministrinë e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit	Anëtar

LISTA NR.2

INSTITUCIONET BASHKËPUNËTORE PËR HARTIMIN E PROJEKTIT KOMBËTAR “STUDIMI RAJONAL I ZHVILLIMIT TË HAPËSIRËS TIRANË-DURRËS”

1. Instituti i Studimeve e Projektmeve Urbanistike
2. Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve
3. Drejtorja e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve
4. Drejtorja e Përgjithshme e Hekurudhave
5. Instituti i Studimeve të Transporteve
6. Enti Kombëtar i Banesave
7. Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
8. Sekretariati Teknik i Ujërave
9. Instituti i Studimit të Tokave
10. Drejtoritë e pyjeve dhe kullotave në qarqet Tiranë e Durrës
11. Zyra qendrore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe degët e tyre në Tiranë dhe Durrës
12. Drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit në qarqet Tiranë dhe Durrës
13. Instituti i Sizmikës
14. Instituti i Hidrometereologjisë
15. Qendra e Kërkimeve Gjeografike
16. Muzeu i Shkencave të Natyrës
17. Instituti i Monumenteve të Kulturës
18. Qendra e Kërkimeve Arkeologjike

19. Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës
 20. Instituti i Statistikave
 21. Këshilli i Qarkut Tiranë dhe Këshilli i Qarkut Durrës
 22. Albtelekom sh.a.
 23. Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
 24. Ndërmarrja Hidrogeologjike
- Lista mbyllet me numër rendor 24

VENDIM
Nr.336, datë 31.5.2006

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, DISA BASHKIVE, TË PRONAVE, TË CILAT JANË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60,
DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL
SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 42 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të miratuara me vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

a) Objekti me numër rendor 8, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç”, Shkodër, kalon në pronësi të bashkisë së Shkodrës.

b) Objekti me numër rendor 16, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç”, Durrës, kalon në pronësi të bashkisë së Durrësit.

c) Objekti me numër rendor 24, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç”, Vlorë, kalon në pronësi të bashkisë së Vlorës.

ç) Objekti me numër rendor 31, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç”, Korçë, kalon në pronësi të bashkisë së Korçës.

d) Objekti me numër rendor 26, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra Polivalente e Zhvillimit”, Sarandë, kalon në pronësi të bashkisë së Sarandës.

dh) Objekti me numër rendor 2, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e Zhvillimit”, Tiranë, kalon në pronësi të bashkisë së Tiranës.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të hiqen nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe shërbimi shoqëror që ofrohet në

to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin dhe personelin.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e grupit 25, titulli 064, kap.1, artikull 600, 601 dhe 602, të grupit 25, titulli 064, kap.5, artikull 600 dhe 602, të buxhetit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, miratuar për vitin 2006 dhe për vitet buxhetore në vazhdim.

5. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetarët e bashkive të përmendura në pikën 1 dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.339, datë 31.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshillit të Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Rreshti i parafundit i shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 246 “-format 520x115 mm figura III 4a/1.” zëvendësohet me:

“-format 520x112mm figura III 4a/1”.

2. Tabela që paraqitet “Figura III 4a/1, neni 248”, zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 7.6.2006
Doli nga shtypi më 12.6.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë